

Shkurt

Nëse gjeni morra koke:

- Zhdukini ata, duke kaluar në flokë një krehër të dendur kundër morrave, pasi të keni vënë zbutësh flokësh, 2 – 3 herë në javë, gjatë një muaji
- Përforcojeni këtë veprim, duke përdorur një produkt kundër morrave me përmbajtje dimetikoni, ditën e 1ë dhe të 8ë (si dhe ditën e 15ë)

Nuk bëhet asnjë trajtim parandalues
<http://www.ge.ch/sseej/videos/poux/>.

Keni pyetje?

Përgjigje mund të merrni

- Pranë infirmierit/es së shkollës

Tel.:

Adresa:

.....

.....

.....

- Promovimi i Shëndetit ValeShëndeti shkollor

Rue des Condémines 14

1950 Sion

Tél : 027 329 04 29

sante.scolaire@psvalais.ch

www.santescolaire-vs.ch

- Për çdo situatë të veçantë, drejtojuni mjekut trajtues.

Të dhëna të tjera për ... morrat e kokës

- Transmetohen përmes kontaktit kokë me kokë
- Ata i duan një lloj si flokët e pastër edhe flokët e papastër
- Ushqehen me gjak njeriu
- Jashtë lëkurës së kokës, ngordhin brenda 48 orëve
- Kapen pas flokëve, e shmangin dritën, nuk kërcëjnë, nuk notojnë, zhvendosen me shpejtësi

Cikli jetësor i morrit

- Morri është një insekt i përhimë, që mund të jetë deri në 4mm i gjatë dhe pjell 7 – 10 vezë (thërija) në ditë të pjesa e fundit e flokut (në centimetrin e parë)
- Morrat e vegjël lindin pas 7 – 10 ditësh
- Që ata të rriten dhe të shtohen, u duhen edhe 7 – 10 ditë



thërija



10 ditë



14 ditë



16 ditë



20 ditë



Gjatësia reale e morrit, 4 mm



Me autorizimin të riprodhimit të teksteve dhe detyrime të Zyritës së Fëmijësisë dhe Rinisë, Shërbëtorit të Shëndetit të Fëmijësisë dhe Rinisë - DIP - Gjenevë
Vizatimi: Simon Tschopp

Morrat po rikthehen!

T'i kërkojmë, t'i trajtojmë vetëm po t'i shohim



Kur t'i kërkojmë ?

- Kur morrat janë të pranishëm rreth nesh (në shkollë, çerdhe, familje, te miqtë ...)
- Në rast se na kruhet koka
- Në rast se kemi thërija në pjesën e fundit të flokëve (ato ngjajnë si zbokth, por hiqen me vështirësi)



Ku dhe si t'i kërkojmë ?

Në kokën e gjithë anëtarëve të familjes :

1. Lagini ose lajini flokët
2. Vini zbutës flokësh me bollëk
3. Krihini flokët me krehërin tuaj të zakonshëm
4. Kaloni në flokë një krehër kundër morrave (që shitet në farmaci) : duke u nisur nga pjesa e fundit e flokëve e deri tek maja e tyre, tufë pas tufe
5. Pas çdo kalimi, fshijeni krehërin me letër pastrimi për të lënë atje morrat e ngelur në të
6. Shpëlani flokët



Nëse nuk gjeni gjë

Përsëriteni kontrollin pas një jave



Nëse gjeni thërija

- Mos bëni asnjë trajtim
- Jini syçelë, se mund të shfaqen morrat ...
- Shihni për morra edhe 2 herë të tjera brenda javës



Nëse gjeni morra

- Njoftoni arsimtarin/en apo edukatorin/en e fëmijës tuaj
- Në të njëjtën ditë : shihini të gjithë anëtarët e familjes dhe trajtojini ata që kanë morra
- Nuk është e nevojshme të pastroni shtrojet, veshjet, gëzofrat ...
- Mundësisht, secili të përdorë furçën e vet të flokëve

Për t'i zhdukur morrat :

- Lagini flokët, vini zbutës flokësh, kaloni krehërin kundër morrave : 2 - 3 herë në javë, gjatë 1 muaji
- Për ta përforcuar këtë veprim, blini në farmaci a në dyqane produktesh higjienike e mirëmbajtjeje ndonjë produkt kundër morrave, me përmbytje *dimetikoni* . Përmbytuni udhëzuesit të përdorimit të tij, dhe merrni masat e duhura . Janë të nevojshme 2 - 3 trajtime (ditën e 1ë e të 8të, si dhe ditën e 15të)



Në rast se trajtimi dështon

- Shihni përsëri kokën e të gjithë anëtarëve të familjes
- Blini një produkt tjetër kundër morrave (*malathion, permethrinë*) : bëni 2 - 3 trajtime (ditën e 1rë e të 8të, si dhe ditën e 15të)
- Për të qenë të sigurtë për zhdukjen e tyre, përdorni një krehër të dendur kundër morrave, çdo dy ditë, gjatë 1 muaji

